REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORIA JURIDIKE,PROKURORIMEVE DHE ASETEVE

Nr. 546 **Prot.** **Lushnje më,** 14/01/**2026**

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

" PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSIA E QEVESISJES VENDORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENSINË SHTETËRORE TË KADASTRËS LUSHNJE"

Të nderuar këshilltare/këshilltarë!

Pranë Institucionit të Bashkise Lushnje,është paraqitur kërkesa e Z.Ergest Krakulli për të përfunduar proçedurën e rregjistrimit të truallit të dhënë për ndërtim nga njësia vendore e cila ka mbetur pa u regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjensisë Shtetrore të Kadastrës " ASHK "Lushnje.

Aplikuesi Z.Ergest Krakulli me adresë Lagjia "Kongresi i Lushnjes", Bashkia Lushnje ka paraqitur dokumentacion të plotë referuar vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2, pika 11.Vendim i Komitetit Egzekutiv Pluralist KP Qytetit Lushnje me nr.51 datë 01.10.1991 pika 12 për dhënie shesh ndërtimi me sipërfaqe 129 m2., Plan nivelimi datë 09.01.2026 të hartuar nga topograf i lishensuar. Shkresës vulosur elektronikisht të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetrore të Kadastrës Lushnje ku pasuria me nr.19/31 , në zona kadastrale 8271 është tokë shtet ,vertetim hipotekor nr.17 datë 03.02.2015, fletë leje ndërtimi , dëshmi e trashëgisë testamentare datë 22.10.2022 pika 2 etj.Dokumenti që këtij aplikuesi i mungon që të krye rregjistrimin e tokës truall është kontrata e shitblerjes së tokës përpara noterit dhe kryerjes së pagesës së truallit në shumen 79980 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lek..

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Këtë atribut aktualisht,për miratimin e procedurës së privatizimit të tokës truall e ka Këshilli Bshkiak ku në zbatim të nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1.2 gërma"a" *Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj*; gërma "c" *E drejta që i mungon që të kryejë rregjistrimin e tokës truallështë kontrata e shitblerjes së tokës para noterit.Ky atribut ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër pika 1.6 gërma"a",neni 54 të* ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*i ndryshuar.Vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2 *"Objekt i këtij vendimi janë tokat e dhëna për për qellime ndërtimi nga bashkitë,ish komunat dhe ish këshillat e rretheve (në vijim të quajtura "organe vendore"pas datës 10.08.1991*,pika 9.1,e kanë Këshillat Bashkiak, të cilat bëjnë të mundur lidhjen e kontratës së shitblerjes me Institucionin e Bashkisë Lushnje.

Faleminderit për mirëkuptimin !

DREJTORIA JURIDIKE
BEDRI HIDA

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.546/11 Prot. **Lushnje më, 14/01/2026**

PROJEKT - VENDIM Nr. 11
" PËR REGJISTRIMIN E TROJEVE TË DHËNA PËR NDËRTIM NGA NJËSIA E QEVERISJES VENDORE TË CILAT KANË MBETUR PA U REGJISTRUAR NË AGJENSINË SHTETËRORE TË KADASTRËS LUSHNJE"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ___/___/2026 sipas relacionit të paraqitur në mbështetje të *nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1.2gërma"a"dhe"c",pika 1.6 gërma "a",neni 54 të* ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*,Vendimit nr.329,datë 22.05.2019 pika 2,pika 4,pika 6,gërma"a"pika 9.1,VKM nr.89 datë 13.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë"neni 192 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë,paragrafi II rregjistrimi i P.P të bëhet në bazë të një akti publik,të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent,si edhe në raste të tjera të parashikuara në ligj"si edhe nenit 193/b të Kodit Civil **JU** :

PROPOZOJMË :

I. Të miratohet përfundimi i proçedurave të rregjistrimit të trojeve të dhëna për ndërtim nga njësia vendore,*sipas dokumentacionit përkatës të ndodhur në dosje për* Z.Pllumb Nuri Krakulli dhe Z.Ergest Pllumb Krakulli.Të paguhet vlera e truallit në shumen 79980(shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lek.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lushnje ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës së privatizimit para noterit.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË
ERISELDA SEFA

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com